


Masat e reja kundër Covidit  
Zgjatet puna e gastronomisë,  
shkurtohet ora policore



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
www.awr-abbruch.de

NË HAGË ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E DHJETË PËR ECURINË  
E ÇËSHTJES NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-së

## SKANDALOZE: ZPS-ja KA FSHEHUR PROVAT SHFAJËSUESE PËR KRERËT E UÇK-SË



Mbrojtja e ish-udhëheqësve të UÇK-së ka akuzuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) se ka fshehur provat shfajësuese për klientët e tyre. Gjatë konferencës së dhjetë për ecurinë e çështjes, Gregory Keohe, avokat i Hashim Thaçit, ka thënë se ZPS-ja për katër vjet ka mbajtur fshehur deklaratën e ish-ambasadori i OSBE-së në Kosovë, Dan Everts, e cila është shfajësuese për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. Ai ka bërë me dije se kjo deklaratë, e cila iu ka dorëzuar mbrojtjes të hënën, hedh dyshime të mëdha mbi provat dhe aktakuzën e ZPS-së

## PAS PRESIONIT PUBLIK, DEPUTETËT FILLOJNË TË TËRHIQEN NGA KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE TË UDHËTIMIT

67 deputetë të Kuvendit të Kosovës që kanë të regjistruar vendbanimin jashtë Prishtinës gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit të kaluar kanë bërë shpenzime të mëdha të karburantit që janë kompensuar nga Kuvendi për të shkuar në seancë dhe në komisione. Në mesin e këtyre deputetëve që u janë kompensuar shpenzimet për udhëtime, 36 janë nga Lëvizja Vetëvendosje. Pas presionit publik, shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë të premtën se deputetët e kësaj partie heqin dorë nga kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit



### AKTUALE



NJË I VDEKUR DHE MBI 1 800  
RASTE ME COVID NË KOSOVË F. 5

RADOIÇIQI DYSHOHET SE FRIKËSOI  
DËSHMITARËT NË RASTIN  
'BREZOVICA' F. 7

AKK-ja GJATË JANARIT KA  
TRAJTUAR RRETH 300 RASTE TË  
LIDHURA ME KORRUPSIONIN F. 7

VELIU: JO LUMIR, NUK MUND TË  
KENË MBËSHTETJE VENDIMET TUA  
KUNDËRSTATUTARE F. 5

### EKONOMI



LIGJI I PAGAVE AFËR HARTIMIT,  
LARG ZBATIMIT F. 8

SHTETASIT E KOSOVËS JANË TË  
TRETËT PËR PUNËSIM NË KROACI,  
TË SHQIPËRISË NË VENDIN E  
GJASHTË F. 8

### SPORT



EKIPI I KOSOVËS PARAKALON NË  
CEREMONINË HAPËSE TË LOJËRAVE  
OLIMPIKE DIMËRORE 'PEKIN 2022'

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVIÇË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Stoltenbergu, shef i ri i Bankës Qendrore të Norvegjisë

OSLO, 4 SHKURT - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, do të bëhet shefi i ri i Bankës Qendrore të Norvegjisë, ka njoftuar qeveria norvegjeze të premtën më 4 shkurt, pavarësisht prej shqetësimeve të opozitës se emërimi i ish-kryeministrit mund ta dobësojë pavarësinë e këtij institucioni.

Stoltenbergu, përpara se ta nisë punën e udhëheqjes së Bankës Qendrore të Norvegjisë, ka thënë se do ta përfundojë mandatin e tij në NATO që mbaron në fund të muajit shtator të këtij viti.

Stoltenbergu do të jetë përgjegjës për përcaktimin e normave të interesit dhe menaxhimin e stabilitetit financiar si dhe mbikëqyrjen e fondit të pasurisë sovraane të Norvegjisë, më i madhi në botë me asete prej 1.4 trilion dollarësh. “Unë kam qenë shumë i shqetësuar në procesin e identifikimit të guvernatorit më të mirë të Bankës Qendrore të Norvegjisë dhe jam i bindur se ky është Jens Stoltenberg”, tha në një deklaratë ministri i Financave, Trygve Slagsvold Vedum, raporton “Reuters”.

Stoltenberg, një ekonomist me profesion dhe ish-udhëheqës i Partisë Laburiste, ishte kryeministër i Norvegjisë në periudhat 2000 - 2001 dhe 2005 - 2013 para se të bëhej shef i NATO-s. Ai ka qenë, gjithashtu, ministër i Financave dhe ministër i Energjisë.

Ida Wolden Bache, zëvendës shefe e Bankës Qendrore dhe rivalja kryesore e Stoltenbergut për këtë pozitë, do të jetë guvernatore në detyrë derisa Stoltenbergu ta marrë zyrtarisht detyrën, tha qeveria norvegjeze.



## Erdogani: Perëndimi po e vështirëson krizën Rusi - Ukrainë



Ankara, 4 shkurt - Kritik ndaj qasjes së shteteve perëndimore është treguar presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, i cili i akuzoi shtetet e Perëndimit se po e bëjnë krizën Rusi - Ukrainë “më të rëndë”. Ai kritikoi qasjen e presidentit amerikan Joe Biden për këtë çështje, në komentet e tij të publikuara nga mediet lokale. “Për fat të keq, Perëndimi deri më tani nuk ka dhënë asnjë kontribut për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Mund të them se vetëm po i përkeqëson gjërat”, u tha Erdogan gazetarëve derisa po kthehej nga Ukraina, duke shtuar se presidenti amerikan Joe Biden “ende nuk është në gjendje të tregojë një qasje pozitive”.

Ndërkohë që diskutimet për krizën Ukrainë - Rusi janë ngritur në nivelin më të lartë, presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, është duke qëndruar në Kinë, ku ka marrë përkrahje nga

udhëheqësit e këtij shteti. Të premtën, më 4 shkurt, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, njoftoi se Bashkimi Evropian ka përgatitur një paketë të fuqishme të sanksioneve financiare për Rusinë.

Leyen tha se BE-ja ka bërë gati “një paketë të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse sanksionesh financiare dhe ekonomike”, nëse Rusia pushton Ukrainën. “Kjo shkon nga kufizimi i qasjes në kapitalin e huaj te kontrollat e eksportit, veçanërisht për mallrat teknike”, ka thënë Von der Leyen, duke shtuar se masat do ta bënë ekonominë ruse ‘edhe më të brishtë’.

Von der Leyen tha se në kuadër të sanksioneve nuk mund të përjashtohet as projekti i shumë diskutueshëm ruse-gjerman i gazit i njohur si “Nord Stream 2”.

## Rritje rekorde e çmimit të energjisë në Mbretëri të Bashkuar

LONDËR, 4 SHKURT - Rregullatori i energjisë në Mbretëri të Bashkuar njoftoi të enjten se kufiri mbi çmimet e energjisë po rritet me një rekord prej 54-përqindësh për shkak të kostove në rritje të gazit natyror, një ndryshim që do të rëndojë ndjeshëm miliona familje që, në të njëjtën kohë, po përballen me rritje të tjera të çmimeve.

Zyra e Tregjeve të Gazit dhe Energjisë Elektrike, e njohur si “Ofgem”, tha se kufiri i ri i çmimit - shuma maksimale që furnizuesit e gazit mund të ngarkojnë klientët - do të rritet për 693 funta në vit në shumicën e pjesëve të Mbretërisë së Bashkuar duke filluar nga muaji prill. Kjo do të

bëjë që fatura vjetore për konsumatorin mesatar të shkojë deri në 1 971 funta.

Vendimi ka të ngjarë të prekë 22 milionë familje në të gjithë vendin.

Shefi i Thesarit, Rishi Sunak, njoftoi menjëherë një paketë masash për të ndihmuar miliona njerëz, përfshirë ata me të ardhura më të ulëta në mënyrë që të përballen me rritjen e madhe të faturave të gazit, raporton AP. “Pa veprimet e qeverisë, kjo do të jetë tepër e vështirë për miliona familje”, u tha Sunak ligjvënësve britanikë.

Njoftimi për shtrenjtim të çmimit të energjisë rrit edhe më shumë një krizë të kostos së jetesës në Mbretëri të Bashkuar, ku kostot e



ushqimit janë rritur vazhdimisht dhe një rritje e taksave do të hyjë në fuqi në muajin prill.

Banka e Anglisë, gjithashtu, ngriti sërish normat e interesit të enjten nga 0.25 për qind në 0.5 për qind

për ta luftuar rritjen e çmimeve të konsumit.

Inflacioni në vend është në nivelin më të lartë në dekada, duke qëndruar aktualisht në 5.4 për qind në dhjetor.

Banka qendrore ka paralajmëruar se mund të rritet në 6 për qind në prill. Disa analistë parashikojnë se inflacioni mund të arrijë në 7 për qind.



NË HAGË ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E DHJETË PËR ECURINË E ÇËSHTJES NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-SË

## Skandaloze: ZPS-ja ka fshehur provat shfajësuese për krerët e UÇK-së



Mbrojtja e ish-udhëheqësve të UÇK-së ka akuzuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) se ka fshehur provat shfajësuese për klientët e tyre.

Gjatë konferencës së dhjetë për ecurinë e çështjes, Gregory Keohe, avokat i Hashim Thaçit, ka thënë se ZPS-ja për katër vjet ka mbajtur fshehur deklaratën e ish-ambasadori i OSBE-së në Kosovë, Dan Everts, e cila është shfajësuese për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. Ai ka bërë me dije se kjo deklaratë, e cila iu ka dorëzuar mbrojtjes të hënën, hedh dyshime të mëdha mbi provat dhe aktakuzën e ZPS-së

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 SHKURT - Avokatët e ish-udhëheqësve të UÇK-së kanë akuzuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) se kanë fshehur provat shfajësuese për klientët e tyre.

Në konferencën e dhjetë për ecurinë e çështjes, ata kanë thënë se në këtë mënyrë ZPS-ja ka shkelur të drejtat e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Para trupit gjykues, Gregory Keohe, avokat i Hashim Thaçit, ka përmendur një deklaratë të cilën e ka dhënë ish-ambasadori i OSBE-së në Kosovë, Dan Everts, e cila është shfajësuese për Thaçin dhe të tjerët.

Sipas tij, ambasadori Everts, para katër viteve, iu kishte thënë zyrtarëve të prokurorisë se veprimtaritë kriminale pas qershorit të 1999-tës nuk janë kryer në ndonjë formë të organizuara, por nga individë që kishin për qëllim përfitime personale.

"I nderuar gjykatës a nuk do të doni të dini se çfarë ai (ambasadori Everts) për klientin tim, z.Thaçi që ka ndërvepruar më ambasadorin Everts gjatë gjithë kësaj periudhe kohore? A nuk do të donit ju të mësoni këtu kur e keni shqyrtuar kërkesën për lirim të parakohshëm? Leni me një anë dyshimin e arsyeshëm, fajin apo pafajësinë. Pra, unë nuk shikojë ndonjë arsyeje ose motiv se pse Thaçi donte që UÇK-ja

donte të kryente krime etnike, sepse kjo do ta dëmtonte reputacionin e tij ndërkombëtar. Për mendimin tim nuk kishte lidhje midis krimeve dhe udhëheqjes qendrore të shqiptarëve të Kosovës. Derisa ne po diskutojmë provat asgjë nga këto nuk iu është dhënë juve, i nderuar gjykatës!", ka thënë avokati Keohe.

Sipas tij, ambasadori Everts ka theksuar se UÇK-ja nuk kishte asnjë mundësi që të nxiste dhunën në teren. "Jo që do të duhej të bëhej i njohur ky dokument, por këtë burra do të duhej të lirohen. Këta burra duhet të lirohen edhe në bazë të dokumentit (ambasadorit Everts) të cilën këta (prokuroria) e lanë aty për këtë vjet. Prokurori duhet të

përpiqet ta gjej të vërtetën. Ju (gjykatës) nuk e keni pasur kurrë këtë dokument! As ne nuk e kemi pasur", ka thënë ai, duke shtuar se nuk është i vetmi dokument që nuk e ka dorëzuar prokuroria. "Ata nuk kanë dorëzuar edhe një dokument nga Departamenti Amerikan i Shtetit, i datës 4 maj 1999", ka thënë Keohe.

Po ashtu, ai ka thënë se as deklaratën e ish-kryeministrit Bujar Bukoshit nuk e ka dorëzuar ZPS-ja.

"Është shumë e papranueshme që këta përfaqësues të prokurorisë qëndrojnë aty sikur s'ka ndodhur asgjë dhe mbajnë këta njerëz në burg, ndërkohë e kishin këtë informacion, i cili dukshëm hedh dyshime mbi provat e tyre. Por, për provat e tjera çka mund të

themi, te cila mund të shkaktojnë probleme të tilla", ka deklaruar ai, duke treguar se si ua dorëzojë prokuroria këtë deklaratë. "Këtë dokument na e dorezën sepse u gjenden gafil dhe problemi i gjykatës nuk është dokumenti, problemi është se ata katër njerëz janë ende në burg. Ndërkohe këta ende nuk na i nxjerrin dokumentet deri në momenti sa i kapim kafil", është shprehur ai. Avokati i ka bërë thirrje gjykatës që t'i lirojë krerët e UÇK-së. "Kjo gjykatë duhet t'i lirojë këta zotëri, me çfarëdo lloj kushti që mund të vendos gjykata, sepse një zyrtarë i lartë i bashkësisë ndërkombëtare ka hedhur dyshime mbi gjithçka që ka përfshirë në këtë aktakuzë që ka bërë ZPS-ja. Nuk mund të mbahen njerëzit në burg në bazë të kësaj", ka thënë ai.

Kurse, avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka kërkuar të di nga prokuroria se edhe sa materiale shfajësuese ka. "Duam të dimë shumë qartë nga prokuroria se sa materiale tjera shfajësues ka ende në zotërim. Është shumë me rëndësi që ne këtë ta dimë, sepse ka të bëjë edhe me pikën tjetër të rendit të ditës që janë hetimet e mbrojtjes. Ne nuk e dimë se këso materiale tjera do të marrin, sidomos kur bëhet fjalë për materialet shfajësues, të cilat janë jetike për planifikimin e hetimeve të mbrojtjes. Nuk mund të largohemi nga kjo konferencë pa e marrë këtë informacion nga prokuroria", ka thënë Emmerson. Mirëpo, prokurorja Claire Lawson nuk ka treguar se edhe sa materiale të tilla ka.

Ajo ka thënë se prokuroria po bënë përpunimin e materialeve. "Paketat e rregullores 103 janë përgatitur javën që shkoj, në kuadër të procesit në vazhdim e sipër të shqyrtimeve të nxjerrjes", ka thënë ajo.

Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020.

Sipas akuzës, së paku midis marsit 1998 deri në shtator 1999, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi akuzohen për krime lufte.

## Masat e reja kundër Covidit: Zgjatet puna e gastronomisë, shkurtohet ora policore

PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Qeveria e Kosovës ka miratuar të premten masat e reja kundër Covid-19. Ora policore do të fillojë nga ora 00:00 deri në orën 05:00, ndërsa gastronomia do të punojë deri në orën 23:00. Sipas ministrit të Shëndetësisë, Rifat Latifi, ndryshime do të ketë në masat lidhur me personat që hyjnë në

Kosovë, për kufizimin e lëvizjes dhe punën e bizneseve.

"Kemi vendosur lehtësimin gradual të masave që mundësojnë një aktivitet të shtuar ekonomik, njëkohësisht synojmë ta ngadalësojmë infektimin", ka thënë Latifi në një konferencë për medie.

Në masat e reja është thënë se

personat që hyjnë në Kosovë duhet ta kenë certifikatën e vaksinimit të plotë me të dyja doza, ose vaksinimin me një dozë së bashku me një test negativ PCR. Sipas masave të miratuara, bartja e maskës, duke mbuluar hundën dhe gojën, është obliguese në të gjitha rastet në ambientet e mbyllura.







# Pas presionit publik, deputetët fillojnë të tërhiqen nga kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit

67 deputetë të Kuvendit të Kosovës që kanë të regjistruar vendbanimin jashtë Prishtinës gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit të kaluar kanë bërë shpenzime të mëdha të karburantit që janë kompensuar nga Kuvendi, për të shkuar në seancë dhe në komisione. Në mesin e këtyre deputetëve që u janë kompensuar shpenzimet për udhëtime, 36 janë nga Lëvizja Vetëvendosje. Pas presionit publik, shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë të premtën se deputetët e kësaj partie heqin dorë nga kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 SHKURT - Ditët e fundit janë publikuar të dhënat për disa deputetë të Kuvendit të Kosovës, ku për gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit të kaluar kanë bërë shpenzime të mëdha të karburantit, për të shkuar në seancë dhe në komisione. Për dy muaj një nga deputetët ka shpenzuar 870 euro për karburante.

Ndër deputetët që kanë shpenzuar më së shumti janë: Pal Lekaj, Yllëza Hoti, Hajdar Beqa, Armend Zemaj, Gramos Agusholli, Agon Batusha, Duda Balje, Albana Bytyqi, Artan Abrashi, Fatmire Kollçaku, Haxhi Avdyli dhe Mërgim Lushtaku.

Aktualisht në legjislaturën VIII të Kuvendit janë 67 deputetë të cilët kanë të regjistruar vendbanimin jashtë Prishtinës dhe prej tyre 36 janë nga Lëvizja Vetëvendosje.

Më 10 tetor 2011, kryetari i Kuvendit të atëhershëm Jakup

Krasniqi kishte nënshkruar një vendim në të cilin thuhet se kompensohen shpenzimet për udhëtim të deputeteve për seanca plenare, të cilët janë regjistruar me vendbanimin jashtë Prishtinës. Sipas këtij vendimi, deri në 30 kilometra deputeti kompensohet me 10 euro, deri në 60 kilometra kompensohen me 20 euro, ndërkaq me mbi 60 kilometra deputetët që udhëtojnë jashtë Prishtinës kompensohen me 30 euro.

Ky vendim i cili doli në media solli reagime të shumta në vend.

Analisti Imer Mushkolaj ka thënë se ndërprerja e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për deputetët nuk është çështje vullneti, por duhet të rregullohet ligjërisht. "Tërhiqeni ose ndryshojeni vendimin e vitit 2011", ka shkruar Mushkolaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Pas presionit publik, shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-

Lila, ka thënë se deputetët e kësaj partie heqin dorë nga kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit. Kusari-Lila thotë se këtë vendim e kanë marrë pas publikimit të të dhënave për shpenzimet e disa deputetëve për karburante. Gjithashtu, Kusari-Lila thotë se do të kërkojnë nga kryesia e Kuvendit që t'i rishikojë vendimet për kompensimin e deputetëve. "Me anë të këtij njoftimi duam të informojmë opinionin publik, se deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, si shumicë parlamentare, vullnetarisht do të tërhiqen nga kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe njëkohësisht thërrasin edhe deputetët tjerë të aplikojnë të njëjtin standard. Gjithashtu, do të kërkojmë nga Kryesia e Kuvendit, rishikimin e vendimit për kompensimin e deputetëve", ka deklaruar ajo. Profesori universitar Avdi Smajllaj ka reaguar pas lajmit se deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje do të tërhiqen nga kompensimi i shpenzimeve të

udhëtimit. Smajllaj në "Facebook" ka shkruar se çdo vendim që mund të marrin pushtetarët tani, për shpenzimet e deputetëve, vjen nga presioni publik dhe mediet që bënë publike këto babëzi të deputetëve. "Dhe nuk vjen nga vullneti dhe qëllimi i mirë i pushtetarëve. Madje, pushteti

mund të përpiqet ta shes ketë të qytetarët si diçka që ata po e bëjnë nga qëllimi i 'mirë", ka shkruar profesori Smajllaj. Autori i emisionit "Rubikon", gazetari Adriatik Kelmendi, ka përshëndetur vendimin e deputetëve të LV-së për tërheqje nga kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit. "Më

## 10 SHPENZIMET PËR KARBURANTE PËR SEANCA DHE KOMISIONE (NËNTOR - DHJETOR 2021)

	<b>PAL LEKAJ</b> AAK – GJAKOVË	<b>870</b>		<b>DUDA BALJE</b> SDU – PRIZREN	<b>870</b>
	<b>YLLËZA HOTI</b> VV – PRIZREN	<b>810</b>		<b>ALBANA BYTYQI</b> AAK – SUHAREKË	<b>780</b>
	<b>HAJDAR BEQA</b> PDK – GJAKOVË	<b>750</b>		<b>ARTAN ABRASHI</b> VV – PRIZREN	<b>690</b>
	<b>ARMEND ZEMAJ</b> LDK – DEÇAN	<b>690</b>		<b>FATMIRE KOLLÇAKU</b> VV – PEJË	<b>660</b>
	<b>GRAMOS AGUSHOLLI</b> VV – PEJË	<b>630</b>		<b>HAXHI AVDYLI</b> VV – PRIZREN	<b>630</b>
	<b>AGON BATUSHA</b> VV – GJAKOVË	<b>570</b>		<b>MËRGIM LUSHTAKU</b> PDK – SKENDERAJ	<b>540</b>



## Një i vdekur dhe mbi 1 800 raste me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 4 SHKURT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të premten se gjatë 24 orëve të fundit është regjistruar një rast i vdekjes si dhe 1 853

raste të reja me Covid-19. Këto raste pozitive kanë rezultuar pas testimit të 9 253 mostrave. Shkalla e pozitivitetit nga mostrat e

marra është 20 për qind. Aktivë me Covid-19 në Kosovë janë 31 084 qytetarë, ndërsa në 24 orët e fundit janë shëruar gjithsej 1 639

persona. Me dy doza janë vaksinuar deri më tani 807 383, ndërsa janë imunizuar me dozën e tretë 86 437 qytetarë.



# Veliu: Jo Lumir, nuk mund të kenë mbështetje vendimet tua kundërstatutare

PRISHTINË, 4 SHKURT - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Agim Veliu, i është drejtuar me një shkrim të gjatë kryetarit të kësaj partie, Lumir Abdixhikut, ku ka shprehur pakënaqësitë lidhur me zgjedhjet për kryetar dege në Podujevë. Sipas tij, në degën e LDK-së në Podujevë është emëruar një kryetar i paligjshëm, duke aluduar për Ekrem Hysenin.

Veliu ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", se Lumir Abdixhiku i janë dashur më shumë se dy muaj ta kuptojë se kandidati i tij i ka humbur zgjedhjet në Podujevë. "Lumir, pse nuk u organizua asnjë takim i Kryesisë së Degës dhe Komisionit për vlerësim të gjendjes në Dege pas zgjedhjeve? Pse nuk prite një raport për gjendjen në Degë? Pse gjithë ajo ngutë e mobilizim që gjatë natës të thirret një kuvend për të zgjedhur një kryetar, pa kryesi?", ka shkruar Veliu. Ai ka thënë se nuk mund të kenë mbështetje të gjerë vendimet kundërstatutare të Abdixhikut. "Lumir, si mund të jetë kryetar i Degës personi që nuk është as delegat/anëtar i Kuvendit të Degës Kryetari i Degës është edhe kryetari

Kryesisë së Degës dhe kryetar i Kuvendit të Degës. Pra, si mund të jetë kryetari Kuvendit të Degës personi që nuk është as anëtar i Kuvendit? Kryesia e LDK-së nuk mund ta legjitimojë një shkelje kaq të madhe të rregullores dhe statutit. Apo, ndoshta edhe do t'i legjitimojë Kryesia të gjitha shkeljet kryetarit Lumir, sepse ai tashmë është vetë Statuti i LDK-së", ka shkruar Veliu.

Ai ka thënë se Lumir Abdixhiku dhe grupi i tij, kryesia e LDK-së, duhet të marrin përgjegjësi për vendimin antistatutar, të paligjshëm dhe përçarës për Degën e Podujevës. "Lumiri mund të marrë përgjegjësi sa të dojë, por nuk mund të amnistohet humbja në Podujevë e kandidatit të emëruar nga ai, të veshur me të gjitha kompetencat për ta zgjedhur shtabin, listën e kandidatëve për asamblistë, autonomi të plotë për bërjen e fushatës, financimin marramendës të fushatës. Ti Lumir dhe kryesia që drejton do ta mbani përgjegjësinë e plotë para anëtarësisë për pasojat e instalimit të një kryetari të paligjshëm në Degën e LDK-së", ka shkruar Agim Veliu.



## SHPENZIMET E UDHËTIMIT SIPAS PARTIVE POLITIKE

DHJETOR 2021

LËVIZJA VETËVENDOSJE 6960€

LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS 1510€

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS 1240€

ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS 1230€

GRUPI MULTIETNIK 2160€

LISTA SERBE 910€

FADIL GASHI (PA GRUP PARLAMENTAR) 100€

## Shpenzimet e larta të deputetëve, por cilat janë kompensimet që u takojnë sipas ligjit

Përveç pagës së majme që marrin deputetët e Kuvendit të Kosovës në krahasim me pagën minimale në nivel vendi, ata gëzojnë edhe përfitime të tjera financiare derisa ushtrojnë mandatin e deputetit. Në vazhdimësi deputetët janë kritikuar për

përfitime shtesë dhe shpenzime të tjera nga ana e monitoruesve, shoqërisë civile dhe medie. Por, sipas Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, ata marrin pagën bazë, pagën kalimtare pas përfundimit të mandatit, kompensim për

pjesëmarrje në seanca dhe në takime të komisioneve, kompensim për funksionet parlamentare, kompensim të shpenzimeve mujore, pensionet suplementare dhe të drejta e tjera të përcaktuara me këtë ligj. Mandati i një deputeti zgjatë katër vjet.

vet në "Facebook".

Jusuf Ulaj, i cili është këshilltar për shëndetësi në kabinetin e kryeministrit Albin Kurti, ka reaguar për shpenzimet e deputetëve të Kosovës për derivate. Përmes një shkrimi në rrjetin social "Facebook", Ulaj ka thënë se shpenzimet për karburante duhen sqaruar e ndalur. "Shumë nga ne që në Lëvizjen Vetëvendosje jemi për parime dhe ndaljen e të këqijave në këtë vend, presim reflektim nga Grupi Parlamentar që na përfaqëson! Shpenzimet në karburante

duhen sqaruar dhe ndalur", ka shkruar Ulaj.

Deputeti i LV-së që vjen nga Prizreni, Artan Abrashi, i cili në këtë periudhë dymujore ka harxhuar karburante 690 euro, ka dhënë një sqarim për opinionin. Ai ka shkruar në "Facebook" se, "sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës, që nga koha kur ekziston ky institucion, mbulohe shpenzimet e karburantit për çdo deputet për kryerjen e punëve në Kuvend dhe komisione duke u bazuar në distancën e vendbanimit.

Për hir të transparencës dhe korrektësisë po e shpjegoj. Shumë deputetë nuk jetojnë në kryeqytet, përfshirë edhe mua. Meqë jetoj në Prizren dhe në muajt Nëntor-Dhjetor kam udhëtuar mbi 35 herë Prizren-Prishtinë, me distancë prej 84 kilometra, kam kaluar përafërsisht mbi 2940 km vajtje, 2940 km ardhje. Sipas kësaj logjike të gjithë deputetët duhet të zhvendosen në Prishtinë për ekonomizim të shpenzimeve. Unë këtë gjë nuk mund ta bëjë. Do të jetoj në Prizren", ka shkruar Abrashi.

mirë vonë se kurrë! Lëvizja Vetëvendosje! u tërhoq menjëherë nga pagesat për karburante për deputetët e saj. Presioni publik e bëri të veten.

Ku janë partitë e tjera parlamentare se? Në listë ishin deputetë nga të gjitha partitë. Apo ende janë në gjumë!", ka shkruar Kelmendi në llogarinë e



# I PAMPOSHURI RAFI HALILI



Rudina ZEQIRI

Muaji janar ndër vite ka qenë dhe mbetet ogurzi e tragjik në historinë e popullit tonë që nga vdekja e Gjergj Kastriotit e këtej. Janari i vitit 2022, pas shumë bashkëveprimtarëve të tij, na e mori edhe korifeun e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Rafi Halilin, i cili, pas një sëmundjeje të rëndë dhe vuajtjeve jetësore në shërbim të lirisë, u nda nga jeta qetësisht në familjen e tij në mëngjesin e 28-të të muajit që sapo lamë pas.

## Shënime biografike

I lindur në Gajre të Tetovës më 12 tetor 1950, shkollimin fillor Rafi Halili e mbaroi në vendlindje dhe në Tetovë, ku vazhdoi edhe shkollimin e mesëm. Si gjimnazist i vitit të dytë, në moshën 17 vjeç, ai



bashkë me shokun e bankës, Gafur Lokun, tash dëshmor i kombit, vendosën flamurin kombëtar shqiptar në Tetovë, kurse pas zbulimit torturohet mizorisht nga organet policore të regjimit dhe dënohet me 20 ditë burgim.

Demonstratat e vitit 1968 Rafiu i kishte kuptuar si akt historik ku shtruhej për zgjidhje çështja shqiptare në ish-Jugosllavi, prandaj mori pjesë aktive në to. Arrestohet sërish dhe përjashtohet nga gjimnazi.

Më 1972 Rafiu regjistroi Fakultetin Juridikun në Universitetin e Kosovës. Atje me shokët e tij formoi organizatën "Kushtrimi i Lirisë", e cila kishte objektiv programi bashkimit kombëtar.

Që nga themelimi, nën drejtimin e Rafi Halilit, ajo filloi demaskimin e politikës pushtuese e koloniale të regjimit jugosllav në trevat shqiptare të aneksuara dhunshëm prej tij. Duke pasur organizata karakter politik, por edhe ushtarak, veprimtarët e saj siguruan një sasi armësh të rrëmbyera në institucionet zyrtare. Pasi u zbulua kjo veprimtari, organet e pushtetit shtetëror (UDB) arrestuan veprimtarët, për ta dënuar udhëheqësin Rafi Halili me shtatë vjet burg të rëndë.

Pas liritimit nga burgju, Rafiu vazhdon veprimtarinë çlirimtare, por në konspiracion të thellë, larg familjes. Organet policore bien në gjurmë të tij dhe e rrethojnë më 6 qershor 1982. Në rezistencën me armën që ia kishte dhuruar bashkëveprimtari i tij, Rexhep Malaj, Rafiu plagoset rëndë nga forcat e armatosura deri në dhëmbë dhe dërgohet para gjyqit për t'u dënuar me 20 vjet të tjera burgim. Dhjetë vjet më vonë, bashkatdhetarët e tij organizojnë protestë masive kundër mbajtjes në burg të Rafiut, me ç'rast lirohet nga burgju, por mbahet nën survejim të rreptë policor. Më 2001, në moshë dhe me shëndet të rrënuar, Rafi Halili u bashkëngjitet radhëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

## Veprimtaria

Në orët e rënda të historisë së robërisë të shqiptarëve, Rafiu iu përgjigj kushtrimit, duke bërë betimin solemn para popullit të tij për të luftuar me gjithë shpirtin kryengritës dhe tërë qenien e tij për lirinë e mohuar, të përdhosur



shpejt dhe veprimtarët e saj u dënuan me shumë vite burgim. Rafi Halili me t'u kthyer nga burgju gjen një situatë tërë në vend, me zgjimin e madh shqiptar, por edhe me zgjerimin e fuqizimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në të gjitha viset e pushtuara nga ish-Jugosllavia. "Kushtrimi i Lirisë" doli përsëri në skenën e Lëvizjes, bashkë me organin e saj të shtypit me të njëjtin emër. Vetëm gjatë vitit 1981 në Tetovë, Shkup, Kërçovë, Gostivar, Dibër e Kumanovë u shpërndanë rreth 40.000 trakte politike.

Ndërkaq Buletini "Kushtrimi i Lirisë" shpërnduhej gjerësisht bashkë me gazetën "Liria" të OMLK-së.

Zëri i "Kushtrimit të Lirisë" së Rafiut jehoi në malet e fushat e Atdeut të tij të kërrusur nga robëria, nën katedrat universitare ku studionte, në dhomat e ngushta të konvikteve të studentëve shqiptarë në Prishtinë, në odat e burrave me buzë të çara,



në qarqet patriotike intelektuale, fshatare, punëtore e të rinisurë volucionare, në qelitë e burgjeve - kazamate jugosllave etj.

## Burgu

Pas arrestimit të vitit 1972, Rafiu dënohet dhe dërgohet në Burgun famëkeq të Idrizovës. Aty në kushte të tmerrshme torture dhe vuajtjesh, ai me shokët që gjeti aty dhe me të tjerët që i sollën më vonë, vazhduan veprimtarinë revolucionare. Rafiu ka kujtuar atë kohë duke thënë: "Edhe në Burgun e Idrizovës arritëm të futnim literaturë të ndaluar, që na

shërbente për ngritjen tonë intelektuale dhe aftësimin për të vazhduar luftën drejt realizimit të qëllimeve tona kombëtare. Madje edhe aty rezistonim qoftë përmes grevave, qoftë përmes protestave të ndryshme".

Në Burgun e Idrizovës Rafiu u njoh dhe u lidh si vëllai me vëllanë me veprimtarin e shquar, Heroin e Kosovës, Rexhep Malaj, të cilët u bënë të pandashëm në jetë. Burgimi rreth tetëmbëdhjetë vjet nuk arriti t'ia topiste shpirtin luftarak dhe t'ia shterte energjitë për të qenë deri në vdekje ai Rafiu veprimtar e luftëtar parimor dhe i pamposhtur.

## Figura morale

Rafi Halili ishte stoik në veprimtari, në burgje e në jetë.

Të flasësh për figurën morale, luftarake e humanitare të Rafiut është një kapitull më vete i jetës së tij të bujshme.

Ndijhem e privilegjuar që pata

mikrofonin e kamerave. I detë e Rafiut rridhnin si ujët e Radikës, herë qetë e herë me rrëmbim përmbytës, varësisht nga situatat, nga çasti dhe motivi.

Ky personalitet i përvojës së gjatë me veprimtarinë çlirimtare, me bagazh teorik dhe praktik, me zemrën që rihite për atdheun dhe lirinë e tij, do studiuar dhe njohur gjithanshmërisht, në tërë dimensionin kompleks të tij.

Është për keqardhje fakti që idetë e pikëpamjet e Rafiut për jetën e luftën, për lirinë e veprimtarinë, për politikën e të ardhmen e kombit nuk janë shënuar në tërësi, prandaj i mori me vete në varr. Është bërë për të një libër nga Instituti i Historisë në Prishtinë, por edhe këtu ndonjë tjetër, kurse më 9 shkurt të vitit 2019 kam zhvilluar edhe unë një intervistë të gjatë me të, por as të gjitha bashkë nuk janë mjaftueshëm për Rafi Halilin.

Jeta dhe veprimtaria e Rafiut përbëjnë lëndë me vlerë të lartë historiografike që duhet shfrytëzuar, analizuar e vlerësuar, duke e vendosur në vendin e vet në thesarin e vlerave tona kombëtare.

## Përfundim

Veprimtaria çlirimtare e Rafi Halilit pati jehonë jo vetëm në Tetovën e tij, por në gjithë kombin shqiptar. Kombi ynë do ta kujtojë me pietet ndër mote luftëtarin e paepur për të drejtat legjitime të popullit të vet të shumëvuajtur, burrin vizionar dhe trim, prijës dhe veprues përgjatë një gjysmë shekulli në jetën e tij të lavdishme.

Rafi kurrë nuk bëri pazar me idealet e tij fisnike, ai kishte parimet e tij jetësore që ia mbajtën kurrizin e papërkulur, si kolonat e betonarmesë që mbajnë ndërtime madhore. Rafiu ishte për të gjallë shkollë e edukimit patriotik të brezave shqiptarë dhe do të mbetet i tillë përjetësisht edhe nga amshimi, duke e bërë të gjallë dhe të përjetshëm, jo vetëm kujtimin për të, por edhe porositë e mesazhet e lirisë që rrezaton figura e tij.

*(Kjo fjalë për veprimtarin Rafi Halili është mbajtur nga autorja në Akademinë Përkujtimore të organizuar nga Universiteti i Tetovës, më 3 shkurt 2021, Tetovë)*



## Radoiçiqi dyshohet se frikësoi dëshmitarët në rastin 'Brezovica'

PRISHTINË, 4 SHKURT - Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka rekomanduar suspendimin nga puna për tre zyrtarë policorë pasi dyshohet se kanë dështuar të ndalonin në vendkalimin kufitar në Bërnjak në veri të Kosovës, politikanin serb Millan Radoiçiq, i shpallur në kërkim nga autoritetet e Kosovës.

Prokurori i Prokurorisë Themelore të Ferizajt, Rasim Maloku, ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë se Radoiçiq është në kërkim, pasi dyshohet për ndërhyrje në rastin e njohur si "Brezovica".

"Radoiçiqi dyshohet për 'frikësim gjatë procedurës penale', pasi i njëjti dyshohet për ndërhyrje në dëshmitarë. Ka tentuar t'i frikësojë që të mos dëshmojnë", ka thënë prokurori Maloku.

Më herët IPK-ja ka njoftuar se mbrëmjen e 3 shkurtit Radoiçiq ishte paraqitur në pikën kufitare në Bërnjak dhe se kishte rezultuar se është person në kërkim.

Pavarësisht kësaj, ai ka drejtuar veturën e tij mbrapa dhe është kthyer në drejtim të Serbisë, ndërsa dokumentet e tij kishin mbetur te zyrtarët policorë në këtë vendkalim kufitar. "Hetuesit e IPK-së, në konsultim me Prokurorinë Themelore në Ferizaj, kanë filluar një procedurë

hetimore ndaj tre zyrtarëve policorë, me dyshimin se të njëjtët kanë kryer veprën penale 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar'", thuhet në njoftimin e IPK-së.

IPK-ja bën të ditur se të tre zyrtarët policorë i takojnë Drejtorisë Rajonale Kufitare "Veriu" dhe se që të gjithë janë punonjës në vendkalimin kufitar në Bërnjak.

Policia e Kosovës njoftoi të premten se zyrtarët kufitarë kanë ndaluar automjetin dhe kanë filluar procedurat e regjistrimit dhe verifikimit të automjetit dhe personave në automjet. "Gjatë realizimit të detyrave policore, zyrtarët kufitarë kanë kërkuar nga personi (voztësi) që ta parkojë automjetin në vend parking, për të vazhduar me procedurat e mëtejme policore, mirëpo voztësi gjatë parkimit me veturë është larguar me shpejtësi mbrapa në drejtim të territorit të Serbisë", thuhet në njoftimin e policisë.

Ndër të tjera, thuhet se zyrtarët policorë nuk kanë arritur ta ndalojnë automjetin.

Lidhur me këtë ngjarje ka reaguar Lista Serbe, nënkryetar i së cilës është Radoiçiq.

Sipas saj, "përpjekja për ta arrestuar Milan Radoiçiqin paraqet persekutim të



përfaqësuesve politikë serbë, të cilin Prishtina nuk mund ta kontrollojë". "Për hir të së vërtetës, theksojmë se në bazë të informacioneve që disponojmë, kërkesa për arrestimin e zotit Radoiçiq nuk përmban asnjë provë apo ndonjë veprim të kundërligjshëm që ai ka bërë, por në përgjithësi flet për një rast të iniciuar në lidhje me dhënien e lejeve për ndërtimet në komunën e Shtërpçës, me të cilat Radoiçiq nuk ka të bëjë", thuhet në deklaratë.

Brezovica është e njohur për qendrën e skijimit.

Në dhjetor të vitit 2021, lidhur me rastin "Brezovica" u arrestuan dhjetë persona, përfshirë edhe ish-kreun e komunës së Shtërpçës nga Lista Serbe, Bratislav Nikoliq. Ai dyshohet se ka fituar në mënyrë të kundërligjshme një milion euro. Nikoliq dhe të arrestuarit e tjerë dyshohet se kanë marrë vila vetura dhe dhurata të tjera në këmbim të lëshimit të lejeve për ndërtimin e vilave dhe objekteve të tjera në Parkun Kombëtar "Sharri", ku gjendet edhe Brezovica.

Më 6 janar autoritetet e Kosovës njoftuan se lidhur me rastin "Brezovica" kanë ngrirë rreth 6

milionë euro të të pandehurve, që dyshohet se i kanë përfituar në mënyrë të kundërligjshme.

Në muajin dhjetor të vitit të kaluar, Radoiçiq dhe disa serbë të tjerë nga Kosova u vendosën në listën e sanksioneve të Departamentit të Thesarit të ShBA-së.

Departamenti i Thesarit tha se grupi i sanksionuar është angazhuar në skema të mëdha të rryshfetit me zyrtarë të sigurisë, kosovarë dhe serbë, të cilët lehtësojnë trafikimin e paligjshëm të mallrave, parave, narkotikëve dhe armëve midis Kosovës dhe Serbisë.

## AKK-ja gjatë janarit ka trajtuar rreth 300 raste të lidhura me korrupsionin

EPOKA

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 SHKURT - Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) gjatë muajit janar 2022 ka trajtuar rreth 300 raste të lidhura me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. "Në kuadër të zbatimit të kornizës ligjore për parandalimin dhe luftimin e Korrupsionit, Agjencia Kundër Korrupsionit përgjatë muajit janar 2022, pasi ka përfunduar hetimet në aspektin administrativ, ka trajtuar 298 raste të lidhura me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit për procesin e deklarimit të pasurisë,



parandalimin e konfliktit të interesit, parandalimin e korrupsionit në prokurimin

publik dhe raste të tjera të trajtuara sipas detyrës zyrtare", ka njoftuar kjo agjenci.

Sipas këtij njoftimi, gjatë muajit janar 2022 Agjencia Kundër Korrupsionit ka zhvilluar procedurën e hetimeve paraprake për 167 raste, dy kallëzime penale dhe një informatë janë finalizuar në janar, ndërsa janë dorëzuar në Prokurorinë e Shtetit në shkurt, si dhe një informatë është dorëzuar në Policinë e Kosovës. "Në raport me veprimet për kontrollin e plotë të pasurisë, AKK-ja ka përfunduar kontrollin e plotë të pasurisë për 80 raste, 20 nga rastet i janë nënshtruar kontrollit të plotë të pasurisë, janë bartur për hetim të mëtejshëm, ndërsa për dy raste është hapur procedura pas

pranimit të denoncimeve. Në aspekt të parandalimit të konfliktit të interesit, gjatë muajit janar 2022, AKK-ja ka iniciuar 12 raste të reja, ka ofruar 9 përgjigje për subjektet që kanë adresuar kërkesa për sqarim të situatave të dyshuara për konflikt të interesit, si dhe janë mbyllur 9 raste të tjera të trajtuara, nga të cilat një me dorëheqje të zyrtarit të lartë nga një funksion publik. Përkritazi me fushëveprimin ligjor, AKK-ja ka ofruar 9 përgjigje për të gjitha subjektet që kanë adresuar kërkesa për ofrimin e përgjigjeve në AKK për parandalimin e konfliktit të interesit", është bërë me dije në njoftimin e AKK-së.

## Buka në furrat e Malishevës përmbush standardet

MALISHEVË, 4 SHKURT - Inspektorët komunalë në Malishevë, të prirë nga drejtoresha e Drejtorisë së Inspektoratit, Besartë Kryeziu-Ramaj, kanë bërë inspektim të përgjithshëm të furrave të bukës, ku përfshihet pesha, përdorimi i aditivit, higjiena, si dhe zbatimi i masave kundër Covidit, përfshirë edhe vaksinimin e punëtorëve. Gjatë këtij inspektimi është

vërejtur se furrat në përgjithësi i zbatojnë standardet e deklaruara për bukën dhe prodhimet e tjera që i shërbejnë, po ashtu edhe pastërtia brenda hapësirave të gatimit dhe të shitjes ishin në rregull dhe brenda standardeve, si dhe zbatimi i masave kundër Covidit. "Gjendja është e mirë në furrat e bukës dhe furrtarët i zbatojnë të gjitha deklaratimet që i kanë,

por ne si inspektorat në vazhdimësi do t'i bëjmë inspektimit e furrave, por edhe të markeve, për produktet ushqimore, me qëllim të ruajtjes së shëndetit, por edhe ofrimin e shërbimeve cilësore për konsumatorët", ka thënë drejtoresha Kryeziu-Ramaj, e cila ka përsëritur apelin e saj për konsumatorët, që sa herë hasin në parregullsi, t'i informojnë inspektorët.





# Ligji i pagave afër hartimit, larg zbatimit

PRISHTINË, 4 SHKURT - Projektligji i pagave për sektorin publik pritet që muajin e ardhshëm të arrijë në Kuvendin e Kosovës për miratim, thonë zyrtarë të qeverisë. Nëse arrin të miratohet në këtë periudhë, zbatimi i tij nuk mund të fillojë deri në gjysmën e dytë të vitit, thonë anëtarë të Komisionit për Ekonomi dhe Financa në Kuvendin e Kosovës. Por, Sindikata e Punëtorëve e Policisë dhe e ajo e Arsimit shprehen se duhet të përshpejtohet miratimi dhe zbatimi i këtij ligji për shkak të ngritjes së çmimeve të konsumit. Çmimet e produkteve të konsumit në dhjetor të vitit të kaluar janë rritur për 6.7 për qind.

Ligji i pagave është miratuar në muajin shkurt të vitit 2019 dhe ka hyrë në fuqi në mars. Por, në dhjetor të vitit 2019 institucioni i Avokatit të Popullit këtë ligj e dërgoi në Gjykatën Kushtetuese për, siç u tha, "vlerësimin e përputhshmërisë" së këtij ligji me Kushtetutën. Sipas vendimit të gjykatës, ligji nuk është në përputhshmëri me 11 nene të Kushtetutës së Kosovës dhe shkakton "çrregullim të ndarjes së pushteteve në disfavor të gjyqësorit dhe institucioneve të pavarura". Ligji i shfuqizuar, aktualisht,

është në fazën e fundit të hartimit dhe së shpejti pritet të fillojë edhe procesi i konsultimeve paraprake, pastaj edhe konsultimeve publike, thuhet në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë" nga zyra e kryeministrit të Kosovës. Për këtë, qeveria, thuhet në përgjigje, ka filluar të kontaktojë me të gjitha sindikatat relevante.

Sindikata e Policisë dhe ajo e Arsimit kanë konfirmuar se i kanë marrë ftesat për dërgimin e emrave të përfaqësuesve të tyre, por deri më tani nuk është caktuar ndonjë takim. Por, ata kanë theksuar se nuk do të pajtohen me projektligjin për paga, në rast se kërkesat e tyre nuk përfshihen në këtë dokument.

Imer Zeqiri, kryetar i Sindikatës në Policinë e Kosovës, thotë se nuk do të pranohet koeficienti i njëjtë i pagave për zyrtarë policorë me koeficientet në ligjin e shfuqizuar. Në ligjin e shfuqizuar koeficienti për pjesëtar të policisë ka qenë 2.2 apo rreth 470 euro, kurse me projektligjin aktual sindikata kërkon që paga bazë të mos jetë nën 600 euro, pa përfshirë kompensimet për punën jashtë orarit, ndërrimin e natës dhe rrezikshmërinë.

Më shumë se 9 200 llogaritet të

jetë numri i punonjësve të Policisë së Kosovës. Paga bazë e tyre aktualisht është 392 euro. "Është i vetmi institucion ku puna është me rrezikshmëri të lartë për jetën dhe shëndetin e punonjësve, për këtë ia vlen të mendohet mirë sa i përket nivelit të pagave. Është një ndër institucionet më të rëndësishme që meriton të ketë rritje në mënyrë që policia të ndihet që po e respekton dikush dhe ka një dinjitet", thotë Zeqiri.

Sipas Ligjit të pezulluar, paga bazë është ajo pjesë e pagës që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë të një funksioni apo pozite të caktuar. Vlera e pagës bazë llogaritet duke shumëzuar koeficientin e klasës së pagës me vlerën monetare të koeficientit. Raporti i koeficienteve është një me dhjetë (1:10).

Koeficienti më i lartë është 10, pozitë kjo që e mban vetëm presidenti i Republikës së Kosovës, më pas është niveli 9, ku bëjnë pjesë kryetari i Kuvendit, kryeministri dhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Me koeficientin 9, paga arrin në 2 150 euro.

Përveç Sindikatës së Policisë, miratimin e këtij projektligji tashmë sa herë e kanë kërkuar

edhe Sindikata e Arsimit, ajo e Shëndetësisë dhe Sindikata e Zjarrfikësve.

Paga e mjekut specialist aktualisht është 600 euro, 470 euro pagë mujore marrin mesimdhënësit në arsimin parauniversitar, kurse nga 280 deri në 330 euro është paga për zjarrfikësit.

Rrahman Jasharaj, kryetar i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, thotë se nëse nuk përfshihen në projektligj kërkesat e SBASHK-ut, në "sistemin e arsimit parauniversitar nuk do të ketë qetësi".

Kërkesat e SBASHK-ut janë që të nivelizohet koeficienti i pagës së punonjësve arsimorë të ciklit të ulët me punonjësit e arsimit të mesëm të lartë. "Mësuesit dhe arsimtarët me ligjin e ri duhet të jenë të barabartë sa i përket koeficientit, ashtu siç janë edhe tashmë. Nëse nuk përfillen propozimet tona të argumentuara, atëherë qeveria le ta dijë se po na dërgon drejt një situatë tjetër dhe kongresi mund të sjellë vendim për grevë të përgjithshme në tërë sistemin arsimor", ka deklaruar Jasharaj. Por, edhe nëse projektligji i pagave miratohet në muajin mars në Kuvendin e Kosovës, zbatimi i tij nuk mund të nisë menjëherë për shkak se ky

projektligj nuk është përfshirë në buxhetin e këtij viti, thotë kryetari i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në Kuvendin e Kosovës, Ferat Shala. "Ligji i pagave duhet të ketë implikime të larta buxhetore dhe nuk mund të hyjë pa rishikim të buxhetit apo në fillim të vitit të ardhshëm. Ende nuk dihet kostoja e tij, pasi ende nuk ka arritur në komision për shqyrtim", ka theksuar Shala për "Radion Evropa e Lirë".

Rishikimi i buxhetit-ndryshimi i Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, bëhet zakonisht në gjysmëvjetorin e dytë, respektivisht në muajin qershor. Numri i punonjësve që marrin paga nga buxheti i Kosovës është rreth 83 mijë veta. Paga mesatare neto, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, është 542 euro, kurse paga minimale është 130 euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç dhe 170 euro për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç. Vlera e pagës minimale në Kosovë është më e ulëta në rajon, pasur nga Shqipëria me 248 euro. Në Bosnjë-Hercegovinë paga minimale është 300 euro, në Maqedoni të Veriut 359 euro, në Serbi 401 euro dhe në Mal të Zi paga minimale është 533 euro.



## Shtetasit e Kosovës janë të tretët për punësim në Kroaci, të Shqipërisë në vendin e gjashtë

PRISHTINË, 4 SHKURT - Deputetja shqiptare në Kroaci, Ermina Lekaj-Prljaskaj, ka bërë me dije se në Republikën e Kroacisë janë të punësuar 7 912 shqiptarë nga Republika e Kosovës. Prljaskaj në një shkrim të publikuar në "Facebook" ka bërë me dije se

shtetasit e Kosovës janë të tretët me vend pune në Republikën e Kroacisë, ndërsa ata të Shqipërisë në vendin e gjashtë. "Sipas të dhënave të fundit të MBP-së gjatë vitit 2021 në Republikën e Kroacisë janë të punësuar 7 912 shqiptarë nga Republika e

Kosovës, d.m.th shtetasit kosovarë janë të tretët me vend pune në Republikën e Kroacisë. Nga Republika e Shqipërisë janë të punësuar 3 719 shtetasit shqiptarë janë të gjashtë me vend pune në R. e Kroacisë", ka shkruar Lekaj-Prljaskaj.





# Historia misterioze e kërkimit të Zotit nga njeriu



Rindërtimi i mënyrës se si njerëzit e kanë imagjinuar Zotin me kalimin e kohës, mund të sjellë me vete shumë surpriza. Kjo sepse Perënditë u janë shfaqur njerëzve në një larmi të pafundme formash. Madje edhe Zoti ynë, ai i hebrenjve, të krishterëve dhe myslimanëve, duket se ka pasur identitete të ndryshme në kohët e lashta.

## Zoti i kafshëve

Paraqitja e parë e një hyjnie në formë njeriu, por me brirë dreri dhe lëkurë ujku, është zbuluar në Shpellën e Tre vëllezërve në Francë, dhe daton rreth 25 mijë vjet më parë. Figura paraqet një shaman të hyjnizuar (një lloj prifti primitiv që ishte në kontakt me shpirtrat).

Në kohët parahistorike, kur hynin në një gjendje ekstaze, shamanët pretendonin se depërtonin në botën e shpirtrave. Ata ishin hyjnitë zoomorfike, pra me forma kafshësh, që konsideroheshin si Zota të specieve të gjuajtura (Zoti i Mamuthëve, Zoti i Kalit të Egër, Kau të Egër e kështu me radhë, siç janë ato të përshkuara në shpellën Lasho).

Më vonë hyjnia mori tipare femërore në Epokën e Paleolitit dhe me lindjen e bujqësisë. Statujat e shenjta të Venusit me barkun, gjoksin dhe të pasmet e theksuara, përshkruanin hyjninë Nënë, mbrojtësen e pjellorisë. Më në fund, me pushtimet e popujve luftarakë Kurgan që

vinin nga fushat e Vollgës, dhe me përhapjen e luftës në Evropë, u shfaqën hyjnitë mashkullore. Ishin Zotat e ushtrive, “flamujt” e popujve të ndryshëm. Nëse një popull fitonte mbi një tjetër, kjo donte të thoshte se Zoti i tyre ishte më superior.

## Zoti i Biblës

Megjithatë, me Jahve-n, Perëndinë hebraike të Biblës, gjërat shkuan ndryshe. Edhe pse humbi, me popullin e tij në mërgim, ai konsiderohej krijuesi, i vetmi Zot i vërtetë, i të gjithëve, dhe jo vetëm një mbrojtës i popullit të tij. Dhe ky imazh i ri i Zotit, u përhap falë mjetit të frikshëm teologjiko-popullarizues të Biblës.

Por u desh të kalonte shumë kohë, dhe sot dihet që ai ishte rrugëtim i gjatë. Duke analizuar Shkrimet e Shenjta me metodën historiko-kritike, studiuesit kanë zbuluar se monoteizmi u vendos në një mënyrë disi të ndryshme nga ajo që besohet zakonisht.

Edhe pse hebrenjtë konsiderohen si pionierë, sot hipotetizohet se origjina e tij e vërtetë është tek hyjnia egjiptiane Aten, disku diellor (i quajtur edhe Amen, i njëjti term me të cilin përfundojnë sot lutjet e të krishterëve dhe myslimanëve).

Kur në Egjipt u rivendos politeizmi, besimtarët e Aten, të mërguar më herët, e kishin eksportuar monoteizmin. Themeluesi i psikanalizës,

Sigmund Frojd, spekuloi se Moisiu ishte në fakt njëri prej tyre. Por kalimi në monoteizëm nuk ishte i drejtpërdrejtë.

Një nga emrat biblikë të Zotit, Elohim, është një emër në shumës: shumësi i Eloah. Tek Zanafilla (1, 26) ai thotë: “Ta krijojmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë!”. Shpjegimi i zakonshëm, është se ishte një formë e shumësit mbretëror për të lartësuar figurën e Zotit.

## Nuk do të kesh Perëndi të tjera...

Por sot është ngritur hipoteza, se është në fakt një gjurmë gjuhësore e një faze të mëparshme politeiste të fesë hebraike, e ndikuar nga kultet e tokës së Kananit, drejtuar perëndisë El. Eloah lexon “Allah”, term me të cilin myslimanët i drejtohen Zotit.

Dhe nuk është e vetmja afërsi. Nuk duhet harruar se sipas Shkrimeve të Shenjta, Abrahami, profeti i besëlidhjes me Zotin, është paraardhësi i 3 feve të mëdha monoteiste, nëpërmjet djemve të tij, Isakut (linja hebreo-kristiane) dhe Ismaelit (linja arabo-muslimane).

Prandaj, ka të ngjarë që hebrenjtë të kenë pasur një formë të monolatrisë (pra një fazë në të cilën nderohej një Zot i shquar, por duke pranuar se kishte të tjerë pranë tij), dhe madje edhe përpara epokës së politeizmit.

Nëse nuk do të ishte kështu, pse duhet të thuhet tek Dhjetë

Urdhëresat: “Nuk do të keni perëndi të tjera para meje” (Eksodi 20:3)? Dhe pse duhet të këndonin izraelitët pas kalimit të Detit të Kuq “Kush është si ti midis perëndive, o Zot” (Eksodi 15:11)?

## Gruaja e Zotit

Hyjnia e qytetit Ugarit, El (Elohim i përmendur në Bibël), kishte për grua Asherah-un, po edhe fëmijë. Nga këtu mund të burojë shprehja biblike “fëmijët e Zotit”. Në rrotullat e Detit të Vdekur, një koleksion tekstesh të shenjta që variojnë nga shekulli I deri në shekullin III Pas Krishtit, lexojmë një version më të vjetër të Ligjit të Përtërirë biblik, sesa ai i teksteve kanonike.

Aty shkruhet se çdo anëtar i familjes hyjnore merr nga El një komb, dhe Izraeli është kombi që i përket Jahves (Dt 32: 8-9). Fëmijët e Zotit thirren që të përulen përpara Zotit në Psalmin 29. Për më tepër, ka shumë pasazhe biblike në të cilat përmendet Zoti, megjithëse në një pozicion epërsie, brenda një panteoni ku ndodhen edhe Perëndi të tjera.

Për shembull “Unë do të lëvdoj përpara Perëndive” (Psalmi 138, 1); “Zoti ynë është më i madh se të gjitha Perënditë e tjera”; “Perëndia është Zoti i zotave” etj. Nëse bijtë e El përfunduan duke marrë një kuptim tjetër, Asherah, i njohur më mirë si Astarte, pati një fat më të keq.

Kulti i saj u çrrënjës, siç mund të

lexohet tek Ligji i Përtërirë 12:3: “Do të shembni altarët e tyre, dhe do t'i fshini emrat e tyre në ato vende”. Megjithatë, kujtimi i Asherah u rikthye me zbulimin arkeologjik të pllakave të gurit me mbishkrimin: “Jahve dhe shoqja e tij Asherah”.

## “Triniteti”, një koncept shumë i lashtë


Edhe kulti i Aten duhet të ketë përfshirë në çdo rast Izraelin. Sot studiuesit mendojnë se Aten u bë “Adonai”, një term tjetër që përdoret për të treguar Zotin në Bibël. Një rindërtim kritik i historisë supozon se mbreti Saul, i angazhuar ushtarakisht kundër filistinëve, vlerësoi se mesazhi i paqes i këtij Zoti egjiptian, nuk ishte i përshtatshëm për një politikë pushtuese.

## Për të ishin më mirë një Zot kombëtar “i ushtrive”.

Për këtë arsye, ai mbështeti kultin vendas të Jahve-s, pa e kundërshtuar kultin e mëparshëm, për të shmangur përçarjen. Kështu tek Zoti ki Izraelit, u bashkuan dy ndjeshmëri fetare: ajo e Aten/Adonait dhe ajo e Jahve-s. Shumëllojshmëria e emrave me të cilët përmendet Zoti në Bibël (Elohim, Adonai, Jahveh) tregonte hyjnitë e ndryshme, të cilat u shkrinë në një në një proces të ngadaltë.

Marrë me shkurtime nga Focus – Bota.al





**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Ekipi i Kosovës parakalon në ceremoninë hapëse të Lojërave Olimpikë Dimërore 'Pekin 2022'

Skitari Albin Tahiri e ka bartur flamurin e Kosovës në ceremoninë hapëse të Lojërave Olimpikë Dimërore "Pekin 2022". Në këto lojëra Kosova përfaqësohet me dy sportistë, Albin Tahiri dhe Kiana Kryeziu, të cilat do të mbahen nga 4 deri më 20 shkurt

**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 4 SHKURT** - Ekipi olimpik i Kosovës ka parakaluar të premten në ceremoninë hapëse të Lojërave Olimpikë Dimërore "Pekin 2022" të cilat do të mbahen nga 4 deri më 20 shkurt. Flamurin e Kosovës e mbajti i vetëm skitari Albin Tahiri, pasi skitarja Kiana Kryeziu mungoi për shkak se trajneri Agim Pupovci ka rezultuar pozitiv në testin për Covid-19.

Ekipi i Kosovës, i përbërë nga pesë persona, ka parakaluar i 54-ti nga 91 ekupe olimpikë pjesëmarrëse. Ky ekip përbëhet nga Bujar Turjaka,

shef i misionit, Jeton Beqiri, zyrtar ndërlidhës për Covid-19, Musa Selimi, anëtar i Bordit Ekzekutiv të KOK-ut dhe Kushtrim Krasniqi, përgjegjës për medie. Kosova në këto lojëra përfaqësohet nga dy sportistë, Albin Tahiri dhe Kiana Kryeziu.

Në stadiumin kombëtar në Pekin të Kinës, ekipi i parë olimpik që ka parakaluar ishte Greqia, pasi ky shtet njihet si themelues i Lojërave Olimpikë. Gjatë Olimpiadës Albin Tahiri do të garojë në katër disiplina të skijimit alpin, sllallom, sllallom i madh, lëshim dhe kombinim alpin, derisa Kryeziu do të garojë në disiplinën sllallom i madh. Ambasadori i Shteteve të

Bashkuar në Prishtinë, Jeff Hovenier, nëpërmjet një postimi në "Twitter", i ka uruar fat dhe sukses ekipit olimpik të Kosovës në Lojërat Olimpikë Dimërore. "I uroj ekipit të Kosovës - dyshes dinamike Kiana Kryeziu, gruas së parë që e përfaqëson Kosovën në Lojërat Olimpikë Dimërore dhe Albin Tahirit, garuesit të parë të Kosovës në Lojërat Olimpikë Dimërore - shumë fat dhe sukses në garë për medalje të artë", ka shkruar Hovenier.

Pas parakalimit në ceremoninë hapëse të Lojërave Olimpikë Dimërore në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar edhe ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. "Jam



jashtëzakonisht i lumtur për defilimin e sotëm të sportistëve tanë në Lojërat Olimpikë Dimërore 'Pekini 2022'. Kosova jonë po valëvitet flamurin e saj nëpër qendrat më të mëdha botërore për vite me radhë falë

përkushtimit dhe sukseseve të sportistëve tanë. U uroj Kianës dhe Albinut që të korrin suksese dhe t'i bashkohen Majlindës, Norës e Distrias në podiumin e të artëve", ka shkruar Haradinaj.

## Irma Konjusha synon të gjykojë ndeshje në garat ndërkombëtare

**PRISHTINË, 4 SHKURT** - Irma Konjusha mori një vendim shumë të vështirë për t'u pensionuar si basketbolliste, pas fitimit të shumë trofeve në karrierën e saj, megjithatë ajo nuk do të largohet nga parketi. Konjusha është gjyqtare e njohur, ndërsa fundjavën e kaluar debutoi në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll si ndër femrat e rralla që gjykon në elitën e meshkujve. Ajo, gjithashtu, është kandidatë potenciale për licencë të FIBA-s. Irma së fundi ishte pjesë e Bashkimit, kurse ka luajtur për Prishtinën dhe Penzën, duke fituar shumë trofe në karrierën e saj. Po ashtu, ka luajtur për Kosovën A të femrave, duke debutuar në garat ndërkombëtare, kurse sa ishte pjesë e skuadrës prishtinase garoi në FIBA EuroCup Women.



*A ishte vendim i vështirë për t'u pensionuar nga basketbolli?*

Konjusha: Sigurisht se ishte vendim i vështirë për t'u pensionuar, pasi është sporti i zemrës sime, ku një pjesë të

madhe të jetës e kam kaluar në parket. Megjithatë, e kam konsideruar se është koha e duhur për t'u larguar si basketbolliste dhe për t'u përkushtuar një profesioni tjetër, me shumë rëndësi për mua.

*Cili është momenti më i mirë në karrierën tuaj?*

Konjusha: Ka shumë. Kam fituar shumë trofe në karrierën time si basketbolliste. Gjithashtu kam garuar në FIBA Europe Cup Women. Por, do ta veçoja debutimin me Kosovën në arenën ndërkombëtare. Ishte hera e parë që garuam në arenën ndërkombëtare. Ishte një përvojë e paharrueshme në Qipro.

*Je femra e parë gjyqtare nga Kosova që synon të gjykojë ndeshje në garat zyrtare të FIBA-s...*

Konjusha: Ky për mua është synimi primar. Si basketbolliste kam fituar shumë trofe, ndërsa si gjyqtare shpresoj se do të licencohem dhe të gjykoj ndeshje ndërkombëtare të organizuara nga FIBA. Do të ishte nder dhe përgjegjësi. Shpresoj që me punë do të arrij këtë qëllim një ditë.

*Cilat janë synimet tuaja si gjyqtare?*

Konjusha: Synimi primar është të gjykoj në arenën ndërkombëtare. Por, sigurisht të gjykoj edhe në basketbollin e Kosovës, pasi garat vendore janë shumë të rëndësishme. Dua të shkoj hap pas hapi, që të ngritem në karrierë. Mendoj se përvoja si basketbolliste do të më ndihmoj shumë në karrierën time si gjyqtare.

*Në fundjavën e kaluar keni debutuar në elitën e meshkujve. Si ishte ky moment për ju?*

Konjusha: Ishte një moment shumë i rëndësishëm. Kam gjykuar shumë ndeshje në Kosovë, por kjo ishte e para në Superligën e Meshkujve. Besoj se do të gjykoj edhe në shumë ndeshje të tjera. Fakti që jam ndër femrat e rralla që ka gjykuar në elitën e meshkujve më jep shtysë dhe motivim për të ardhmen. Me ndihmën e kolegëve besoj se do ta kem më lehtë për të ardhmen.

## Hyseni dhe Çeku flasin për stadiumin e Gjilanit

**GJILAN, 4 SHKURT** - Kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, është takuar me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku. Hyseni ka thënë se temë diskutimi ka qenë stadiumi i qytetit të cilin ka shtuar se bashkë

me MKRS-në e kanë përgjegjësi për ta përfunduar sa më shpejt. "Bashkë me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, zhvilluam një takim të frytshëm me temë diskutimi rreth stadiumit të qytetit. Punimet e

këtij projekti, problematikë e trashëguar, bashkë me MKRS-në e kemi përgjegjësi për t'i kryer sa më shpejt që është e mundur, e sportistëve tanë t'u krijohen kushte sa më moderne", ka thënë Hyseni.





## Prishtina - Bashkimi, sfida kryesore në Superligën e femrave

PRISHTINË, 4 SHKURT - Të shtunën do të zhvillohet xhiroja e 14-t në Superligën e femrave. Derbi i kësaj xhiroje zhvillohet ndërmjet Prishtinës dhe Bashkimit. Vashat prishtinase kanë shënuar 13 fitore në 13 ndeshje të zhvilluara, duke qenë skuadra e

vetme në elitë pa humbje, kurse prizrenaset kanë nëntë fitore e katër humbje. Së fundi shënuan fitore ndaj Penzës. Përballja pritet të jetë shumë interesante, duke marrë parasysh rivalitetin e madh mes këtyre dy skuadrave, që kanë

shumë ambicie në këtë edicion. Takimi do të transmetohet në "Art Motion" dhe "Kujtesa". Kastrioti, që ka 13 humbje në po kaq ndeshje, do të ndeshet me Penzën. Kampionet e Kosovës kanë dhjetë fitore e tri humbje dhe shihen favorite në këtë

përballje. Takimi tjetër i kësaj xhiroje është në mes të Trepçës dhe Vëllaznimit. Mitrovicaset kanë katër fitore e nëntë humbje, kurse skuadra nga Gjakova ka tri fitore dhe dhjetë humbje. Të shtunën takohen: Kastrioti-



Penza (13:00), Trepça-Vëllaznimiti 13:00, Prishtina-Bashkimi (19:00).

## Dy përballje interesante në elitë

PRISHTINË, 4 SHKURT - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 19 në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Të shtunën do të përballen rivalët e vjetër në basketbollin e Kosovës, Bashkimi dhe Trepça. Takimi do të zhvillohet në Rahovec, pasi palestra në Prizren po ka probleme me ngrohje. Prizrenaset kanë tetë fitore e dhjetë humbje, ndërsa mitrovicasit 12 fitore e gjashtë humbje. Takim shumë



interesant pritet në mes të Sigal Prishtinës dhe Rahovecit. Bardhekaltrit kanë nëntë fitore dhe nëntë humbje, kurse rahovecasit pesë fitore e 11 humbje. Rëndësia e përballjes bën që takimi të jetë shumë rivalizues. Ndeshja e fundit është në mes të Dritës dhe Golden Eagle Yllit, sfidë që zhvillohet në

Therandë. Gjilanasit ndodhen në vendin e fundit me 18 humbje, në po aq ndeshje të zhvilluara, duke qenë skuadra e vetme në fitore në elitë pa fitore, kurse therandasit janë në vendin e parë me 14 fitore e katër humbje. Për ndeshjen Peja - Prizreni 16 do të regjistrohet rezultati nga Liga Unike.

### SUPERLIGA - JAVA 19

Të shtunën takohen:  
19:00 Bashkimi - Trepça

Të dielën takohen:  
17:00 Sigal Prishtina - Rahoveci  
19:00 Drita vs Golden Eagle Ylli  
Peja - Prizreni 16 (Rezultati nga Liga Unike)

## Clippersat fitojnë derbin ndaj lakersave

LOS ANXHELOS, 4 SHKURT - Një kosh në sekondat e fundit i Jacksonit (25 pikë,) i dha fitoren ekipit të clippersave, 111-110, ndaj lakersave në derbin e Los Anxhelosit. Një sfidë mes dy ekipesh që kanë zhgënjyer këtë sezon e që luajnë për play off-in. Morris me 29 pikë ishte shënuesi më i mirë për clippersat, ndërsa për lakersat u dallua Davis me 30 pikë e 17 rebounde, por që s'mjaftuan për të fituar. Pa probleme fitoi Golden State me rezultat 126-114 ndaj Sacramentos, duke iu afruar Phoenixit në krye të renditjes në Perëndim, ndeshje ku për



Warriorsin u dalluan Thompson me 23 pikë e Curry me 20. Humbet Phoenixi, që u ndal me rezultat 124-116 nga Atlanta, ndeshje ku për vendasit shkëlqeu Trae Young me 43 pikë, duke i bërë të pavlefshme 32 pikët e Bookerit për Suns-in. Humbet edhe Chicago, 127-120 ndaj Torontos, por e ruan

kreun në Lindje. Për kanadezët, të gjithë titullarët realizuan mbi 15 pikë, ndërsa te Bulls-i u dallua Vuçeviqi me 30 pikë e 18 rebounde, por që mbetën për statistikë. Fitoi edhe Miami me rezultat 112-95 ndaj San Antonios, me Herron protagonist, autor i 24 pikëve.

### REZULTATET

Detroit - Minnesota	117-128
Atlanta - Phoenix	124-115
Toronto - Chicago	127-120
San Antonio - Miami	95-112
Golden State - Sacramento	126-114
Clippers - Lakers	111-110

## Në qershor rimeçi Joshua - Usyk

Promotori i Tyson Furyt, Bob Arum, ka zbuluar se Anthony Joshua do të përballlet me Oleksandr Usykun në qershor, në përpjekje për t'i rikthyer titujt e botës në kategorinë e rëndë për herë të dytë. Joshua u mposht nga

Usyk dhe i humbi titujt e botës në kategorinë e rëndë WBA, WBO dhe IBF në shtator. Ajo ishte vetëm humbja e dytë e Joshuas në karrierë. Joshua e ka shfrytëzuar të drejtën për rimeç me ukrainasin dhe,

megjithëse mendohej se ai do të ndodhte në prill, Arum njoftoi se qershori është muaji i caktuar për këtë luftë. "Ata do të luftojnë në qershor", ka thënë Arum për Joshuan dhe Usykun. Kohë më parë Joshua deklaroi

se vijon të ndihet i zemëruar me veten, pas humbjes kundër Oleksandr Usyk, por këmbënguli se ajo disfatë po e nxit çdo ditë për t'iu hakmarrë ukrainasit. "Unë e di se mund të jem më i mirë se atë natë", ka deklaruar Joshua për "BBC

Sport" në dhjetor. "Është më e lehtë të thuash sesa ta bësh, por në zemër dhe në shpirt, në tru dhe në trup, ndiej vërtet se kam shumë për të dhënë. Jam i zemëruar. Zemërimi po rritet, por po më nxit çdo ditë", ka shtuar britaniku.

### SHKURT

#### Presidenti i UEFA-s: Finalja e Ligës së Konferencës do të luhet në Tiranë

Finalja e Ligës së Konferencës është ende e Shqipërisë. Ardhja e presidentit të UEFA-s, Aleksandër Ceferin të enjten, përveç diskutimeve për zgjedhjet e FSHF-së, ishte edhe për finalen e kompeticionit evropian. Shumë në rrezik ishte vendosur edhe kjo finale, e cila, fatmirësisht, është ende në duart e Shqipërisë. Asnjë ndryshim programimi, ku nëse palët dhe veçanërisht Edi Rama do t'i mbahet premtimit të dhënë te Ceferin, Evropa do të ketë sytë te Tirana për një ditë.

#### Ibra mungon në derbin kundër Interit

Sot (e shtunë) në orën 18:00 do të luhet një nga derbit më të bukur në Itali, por edhe në Evropë, sidomos në këtë edicion, pasi renditja është e tillë në Serinë A, i pari takohet me të dytin. Inter-Milan do të vendosë jo pak për fatet e titullit. Por trajneri i kuqezinjve, Stefano Pioli, ka marrë një lajm të keq. Sulmuesi i Milanit, Zlatan Ibrahimoviç, nuk ia del dot të jetë pjesë e derbit. Suedezi pësoi një lëndim në tendinën e akilit në përballjen e fundit me Juventusin. Shpresat që ai të ishte gati për derbi ishin të vogla, por tani është konfirmuar që nuk do të mund të luajë. Gjithashtu, Ibra nuk do të jetë pjesë e ekipit edhe në sfidën e mesjavës përballë Lazios në garën e Kupës.

#### Ronaldos i intereson se kush do të jetë trajner i ardhshëm i Unitedit

Sulmuesi i Manchester Unitedit, Cristiano Ronaldo, po peshon të ardhmen e tij në "Old Trafford" dhe ajo thuhet se varet nga emri i trajnerit të ardhshëm. Ralf Rangnick është aktualisht në detyrë të përkohshme pasi Ole Gunnar Solskjaer u shkarkua më herët gjatë sezonit aktual. Megjithatë, klubi nga "Old Trafford" ende duhet të konfirmojë se kush do të jetë trajneri i tyre pas fundit të sezonit aktual. Ronaldo është kontraktuar me klubin për një sezon të mëtejshëm pas këtij, por ka disa pasiguri për të ardhmen e tij me klubin që po përballlet me një sfidë të vështirë për t'u kualifikuar në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm. Sipas mediumit ESPN, Ronaldo do të presë të shohë se kush do të jetë menaxheri i përhershëm i klubit për të vendosur nëse ai duhet të qëndrojë edhe për një sezon. Paul Pogba thuhet se e ka bërë të qartë se preferon që në krye të klubit të mbetet Rangnick, por portugezi Ronaldo nuk duket aq i lumtur nëse gjermani mbetet trajner edhe në sezonin e ardhshëm. Erik ten Hag i Ajaxit dhe Mauricio Pochettino i Paris Saint-Germain janë përmendur si dy emrat më të mundshëm për ta marrë drejtimin e Unitedit.



## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Goni Keramikë” SH.P.K. pronar Agron Lipovica ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810032011 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Goni Keramikë” D.O.O. Agron Lipovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810032011 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Goni Keramikë” L.L.C. Agron Lipovica has come to the decision to quit its business: 810032011 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Florent Berisha shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Hajrullah Shala" nga klasa 6-9.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



**MILLENNIUM  
FOUNDATION  
KOSOVO**

## SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Contract for the Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER) – Prishtina
Procurement Ref. Number	RFQ /2022/005
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Works
Employer	Millennium Foundation of Kosovo (MFK)
Publication Date	04 February 2022
Submission Deadline	28 February 2022; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the “Threshold Program agreement”, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for the Contract for the Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER) – Prishtina.

MCC’s funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now bids from eligible bidders for the Works Requirements.

Bidding will be conducted through the *Shopping* procedures as specified in the MCC Program Procurement Guidelines (PPG), and is open to all eligible bidders or consultants as defined in the PPG.

A complete set of Request for Request for Quotation (RFQ) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible bidders through the following website (Eventual clarifications or any changes to the RFQ document shall be published at the latest 3 days before the submission deadline on the link provided below):

<https://millenniumkosovo.org/procurment/procurement-of-contract-for-the-construction-of-apartment-building-efficiency-retrofits-aer-prishtina-2022-005>

A **pre-Bid conference** shall take place at the **10 February 2021, at 14:00** (Kosovo Time), through Zoom meeting link: <https://us02web.zoom.us/j/86718366791>

Bidders interested in submitting bids should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the RFQ to the Procurement manager at [procurement@millenniumkosovo.org](mailto:procurement@millenniumkosovo.org), giving full contact details of the bidder.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link (dropbox link) shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in bids rejection. The File link for submission of bids is included in the RFQ document.

Bids shall be submitted ONLY to the file request link provided in RFQ documents no later than **28 February 2022 at 14:00 (Kosovo Time)**. Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

<b>The address(es) referred to above is (are):</b>	Str. “Migjeni” no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
<b>Attn:</b>	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. “Migjeni” no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
<b>Tel:</b>	00 383 38 752 110
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:procurement@millenniumkosovo.org">procurement@millenniumkosovo.org</a>
<b>Website:</b>	<a href="https://millenniumkosovo.org">https://millenniumkosovo.org</a>





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

